



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 72

Prishtinë, më 8.6.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naim Maloku, Zulf Merxha, Elheme Hetemi, Selvie Halimi, Ali Lajçi, Zef Morina, Berat Luzha, Heset Cakolli, Branislav Grbić.

Mungoi : Naser Rugova, Myrvete Pantina.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : OJQ, zyrtarë nga MMPH dhe MBPZHR, Zeqir Veselaj, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Naim Maloku**, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 1.6.2010,
3. Harmonizimi i qëndrimeve me disa OJQ të interesuara për Projektligjin për mbrojtjen e natyrës,
4. Të ndryshme.

1. Nënkyetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 1.6.2010

Nënkyetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Projektligji për Mbrojtjen e Natyrës

Naim Maloku në fillim tha se ai nuk e ka rekomanduar rendin e sotëm të ditës për këtë mbledhje, pasi që komisioni veç ka formuar grupin punues për shqyrtimin e projektligjit, mirëpo pasi që është caktuar përshëndeti mysafirët që janë prezent dhe **Blerim Velën** nga OSCE i cili mirëpritet në grupin punues për shqyrtimin e këtij projektligji. Meqenëse nga

Qeveria është dërguar një version tjetër i projektligjit, fillimisht kryesuesi ja dha fjalën **Bajram Badivukut-koordinator** i cili sqaroi se pas leximit të parë të versionit me 208 nene të këtij projektligji nga Qeveria është dërguar një version tjetër me 177 nene, mirëpo duke pasur parasysh dispozitat e rregullores së re të Kuvendit (neni 58) kjo çështje duhet proceduralisht të rregullohet, të konstatohet tërheqja nga ministri i versionit paraprak dhe dorëzimi i versionit tjetër të ri.

Naim Maloku ishte për solucionin që mos të detyrohet MMPH ta tërheq sepse komisioni mund të fshij nenet e panevojshme.

Zef Morina mendoj se megjithatë duhet të kthehet ngase mund të lindin situata të padëshirueshme, ngaqë komisioni nuk mund të shtoi dhe as të hjek nene.

Elheme Hetemi ishte e mendimit nëse çdo gjë është e qartë nuk ka vështirësi p.sh. të hiqen nenet e koncesionimit ashtu si u kërkua në seancë, mirëpo nëse ka edhe nene tjera që duhet hequr, atëherë është çështja pak më ndryshe, pra ndoshta duhet të kthehet projekti.

Selvie Halimi tha se duhet të respektohet rregullorja sepse deputetët mund të hutohen nëse tani e marrin projektin me 177 nene, lindin problemet.

Berat Luzha përkrahu sugjerimin e Blerim Velës të amendohet projekti sepse leximi i parë është vetëm lexim në parim dmth komisioni vendos çka të shtohet në projekt e çka jo. Ai tha se nuk ka nevojë për procedim të mëtejshëm.

Heset Cakolli gjithashtu tha se ka pasur dilema në leximin e parë, ndaj çfarëdo që të bëjë komisioni duhet të bazohet në rregulloren në fuqi. Me pajtimin e komisionit **Naim Maloku** formuloi si vijon :

K O N S T A T I M

Pasi që në Kuvend kanë ardhur dy versione të ndryshme të projektligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis do të pret vendimin e Departamentit ligjor të Kuvendit të Kosovës duke u bazuar në procedurën sipas rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4..Të ndryshme

Naim Maloku mori sugjerimin nga stafi çka mund të shqyrtohet për këtë pikë, ndërkaq lidhur me Bordin Mjedisor të propozuar nga Qeveria tha se personalisht nuk është i gatshëm të shqyrtoi këtë çështje ngase sipas tij më mirë do të ishte të caktohet pikë e veçantë lidhur me këtë bord për sot dy javë për shkak të vizitës së komisionit (gjysmës së komisionit) në Bruksel.

Berat Luzha konstatoi se nga komisioni kërkohet kalim formal i propozimit, megjithatë nuk kundërshtoi propozimin që të ftohen këta anëtarë të bordit në komision.

Elheme Hetemi tha se duhet më shpejt të veprohet, dy javë janë shumë.

Naim Maloku konsultoi stafin dhe caktoi mbledhjen për të premtën më 11.6.2010 në orën 13,00 kur do të ftohen anëtarët e bordit që janë propozuar nga Qeveria.

Projektligji për ujitjen e tokave bujqësore ka kaluar nëpër komisionet kryesore, ndaj komisioni konfirmoi atë për leximin e dytë duke fshirë amendamentin 2 (mbeten 8 amendamente) ngase preambula e ligjit në fuqi nuk mund të fshihet për shkak se atëherë është punuar me rregulloret e UNMIK-ut.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,50.

Nënkryetari i Komisionit,
Naim Maloku

